



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DIBËR

DREJTORIA TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

PROJEKT - VENDIM

Nr. 02 datë 25 / 11 /2022

**“ PËR MIRATIMIN E PAKETËS FISKALE TË BASHKISË DIBËR PËR VITIN
2023”**

Këshilli Bashkiak Dibër në mbledhjen e tij të datës ___/___/2022, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Dibër, mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë”, pika 1.1/b, si dhe neni 64 “Kompetencat dhe Detyrat e Kryetarit të Bashkisë” ligjit nr.44/2015 “Kodi i Proçedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë”, ligji nr.687/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

Kërkojmë:

- I. Miratimin e Paketës Fiskale për vitin 2023 të institucionit të Bashkisë Dibër.
- II. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Taksave dhe Tarifave Vendore dhe të gjithë drejtoritë e tjera të Bashkisë Dibër.
- III. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Këshillit Bashkiak Dibër dhe shprehjes për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.

PËR BASHKINË DIBËR:

Përgjegjës Taksave dhe Tarifave Vendore

Bujar Manja

Drejtore Taksave dhe Tarifave Vendore

Lorenc Cibaku

Përgjegjës Sektorit Juridik

Elona Lusha

KRYETARI I BASHKISË

Rahim Spahiu

